



Konferencat për Transport dhe Planifikim Hapësinor në Kosovë

Ftesë

Konferenca #1

Transporti Publik Organizimi, politikat dhe planifikimi

E Mërkurë, 31 Tetor 2007
Prishtinë

Pasqyrë e përgjithshme

Transporti dhe planifikimi hapësinor janë të lidhura ngushtë mes vete si dy anët e një medaljeje. Megjithë që ekspertët e transportit dhe planifikimit hapësinor shpesh herë kanë prioritete, koncepte, instrumente dhe institucione të ndryshme, ata e kanë të përbashkët përgjegjësinë për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm në të cilin funksionet janë të arritshme, transporti është efikas dhe njerëzit mund të lëvizin në suaza lokale, rajonale dhe ndërkombëtare, gjë që do të sigurojë një jetë shoqërore dhe ekonomike të gjallëruar dhe produktive.

Qëllimi kryesor i ciklit të konferencave mbi Transportin dhe Planifikimin Hapësinor është që të mundësohet dialogu ndërmjet partnerëve nga institucionet, disiplinat profesionale, nivelet organizative dhe sektorët e ndryshëm:

- Profesionistët e planifikimit dhe të transportit
- Autoritetet qendrore dhe komunale
- Akterët publik dhe privat

Është e pamundur që të mbulohet fusha e gjerë e transportit dhe planifikimit hapësinor në një konferencë të vetme, ose bile të shohitet një temë e vetme. Prandaj, konferenca e transportit publik do të vazhdojë me një varg konferencash Ministrisë dhe partnerët e tyre iu mirëpresin në këto konferenca interesante dhe stimuluese të cilat do të na ndihmojnë të zhvillojmë një sistem dinamik dhe të qëndrueshëm të transportit publik në Kosovë.



Programi i Konferencës

31 Tetor 2007, Grand Hotel, Prishtinë, Salla e Konferencave, Kati i parë

9:00–10:00

Fjala hyrëse

Qemajl Ahmeti, Ministër i Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit
Ardian Gjini, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

10:00–10:15

Pauza e kafes

10:15–12:00

Sesioni A: Rregullatori, Autoritetet organizative, Operatorët

institucionet e bashkëpunimit publik/publik dhe publik/privat

Rast studimi:

Rrjeti i autobusit ndërrurban: sukseset dhe sfidat

Qamil Feka – Drejtor i departamentit të transportit rrugor, MTPT
Fushë-Kosovë / Obiliq / Prishtinë – Bashkëpunimi ndërkomunal
Islam Shabani – Komuna e Fushë Kosovës

Fjalimi:

Rolet e kompanive private dhe autoriteteve publike në një sistem efikas të transportit publik

Constantin Dellis – Menaxher rajonal, UITP (Asociacioni Ndërkombëtar për Transport Publik)

Diskutimi:

Hasan Shehu – Sekretar i Asociacionit të kompanive private të transportit
Muhamet Malsiu – Drejtor i Departmenti të Mjedisit, MMPH

12:00–13:30

Dreka

13:30–15:00

Sesioni B: Transporti publik në kornizën e politikave

Zhvillimi ekonomik, shëndeti publik, kohezioni social

Rast studimi:

Përmirësimi i qendrës së qytetit, zhvillimi urban dhe transporti publik

Muhamet Morina – Departamenti i shërbimeve komunale, Komuna e Prishtinës
Pasqyrë e përgjithshme e studimit të politikave të Transportit Publik në Kosovë
Ramadan Duraku, Shef i sektorit, MTPT

Fjalimi:

Vlerësimi i investimeve në transportin publik – kostot dhe përfitimet në perspektivën makroekonomike

Frédy Wittwer – Drejtor i Institutit Ndërkombëtar për Edukim të Mobilitetit (Geneva, CH)

Diskutimi:

N.N. – Oda Ekonomike e Kosovës
Tomor Maloku – OJQ Kosovare për Mbrojtjen e Konsumatorëve

15:00–15:15

Pauza e kafes

15:15–16:45

Sesioni C: Transporti publik në planifikimin hapësinor

Rrjetet dhe nyjet

Rast studimi:

Ferizaj: Jetësimi i qendrës së qytetit në bazë të transportit publik: Projekti i qendrës mobile

Mustafë Zariqi - Shef i Sektorit të Planifikimit – Komuna e Ferizajt

Pejë: Planet për rrjetin e transportit urban

Agron Sallova – Këshilltar për planifikimin komunal dhe urban, UN-HABITAT

Rilindja e linjës hekurudhore Prishtinë-Pejë

Xhevat Ramosaj – Drejtor i përgjithshëm, Hekurudhat e Kosovës

Diskutimi:

Jozef Zuallaert - Këshilltar për Rrugë dhe Transport - CBEI
Agim Radoniqi – Drejtor, Departamenti i Planifikimit Hapësinor, MMPH
Ilir Gjinolli – Ligjërues i Urbanizmit, Univerziteti i Prishtinës

16:45–17:15

Mbyllja

Konkluzionet:

Ismet Beqiri, Kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës
Elisabeth Belpaire – Shefe e zyres së UN-HABITAT-it në Kosovë

Sesioni A: Regulatori, Autoritetet organizative, Operatorët
Institucionet e bashkëpunimit publik/publik dhe publik/privat

Brenda një periudhe të shkurtër kohore, në Kosovë kanë ekzistuar dy sisteme krejtësisht të ndryshme të transportit: rrjeti transportues i monopolit shtetëror që ishte i planifikuar dhe administruar në mënyrë qendrore, pas së cilit erdhën operatorët privat dhe të pavarur dhe kombi-busëve, të cilit i ndiqnin udhëtarët në një mjedis të parregulluar. Të dy sistemet kishin përparësitë dhe mangësitë e tyre. Sfida për organizimin e transportit publik në Kosovë, si kudo tjetër, është mobilizimi i përparësive të koordinimit qendror dhe i ndërmarrjes së orentuar kah klientët, që kërkon fitime, dhe evitimi i dobësive të tyre.

Hulumtimet e kësaj Pjese përshkruajnë sukseset dhe vështirësitë e autoriteteve publike qendrore dhe lokale të Kosovës në zbatimin e Ligjit mbi transportin rrugor, ndërkohë që fjalimi kryesor ofron shembuj të modeleve organizative të huaja të cilat lansojnë diskutimin rreth mënyrës se si rregullimi institucional i transportit publik në Kosovë mund të përmirësohet dhe zhvillohet më tutje me futjen në përdorim të konceptit të një autoriteti organizativ ».

Sesioni B: Transporti publik në kornizën politike
Zhvillimki ekonomik, shëndeti publik dhe kohezioni social

Shumë ekonomi familjare janë të gatshme të paguajnë shtrenjtë për transport me vetura. Mirëpo, në njërën anë, shumica e popullatës nuk ka llogari të ketë automjet apo thjesht nuk lejohet të ngasë automjet dhe, në anën tjetër, komunikacioni rrugor kërkon hapësira të mëdha, infrastrukturë dhe shërbime policore, ndërkohë që prodhon fatkeqësi të dëmshme dhe ndotje. Transporti publik mund të ndihmojë në sigurimin e lëvizshmërisë për më shumë njerëz me çmim më të ulët publik dhe privat. Hulumtimet e kësaj pjese tregojnë se si transporti publik ka filluar të luajë rol strategjik në politikën e zhvillimit urban të Prishtinës dhe te jipet një pasqyrë e përgjithshme mbi studimet e politikave të transportit publik në nivelin qendror në MTPT dhe MMPH. Fjalimi kryesor vë në dukje mënyrën se si analizat makro-ekonomike të rentabilitetit dëshmojnë nevojën për investime pasuese në infrastrukturën dhe vepërimtarinë e transportit publik dhe hapë diskutimin rreth zhvillimit të një politike koherente dhe të barazpeshuar të transportit që mundëson lëvizshmërinë efektive dhe efikase të popullit dhe afarizmit, në mënyrë që të mundësohet zhvillimi.

Autobusi i qytetit në Prishtinë

Sesioni C: Transporti publik në planifikimin hapësinor
rrjetet dhe nyjet

Pjesët e përparshme kanë hulumtuar aspektet institucionale dhe makro-ekonomike të transportit publik dhe planifikimit hapësinor. Pjesa e fundit përqendrohet në aspektin fizik të planifikimit të transportit publik, që është detyrë e ndërlikuar shumë-dimensionale: rrjetet e niveleve të ndryshme dhe me funksione të ndryshme duhet të dizajnohen ashtu që t'i realizojnë caqet e tyre përkatëse. Këto rrjete poashtu duhet të ndërliohen, në hapësirë dhe kohë, në mënyrë që ta formojnë një sistem koherent. Duhet ndarë infrastrukturën në mënyrë që të lejojë shërbime efektive dhe, kësajsoj, edhe tërheqëse dhe të lira. Pokështu, rëndësi primare ka zhvillimi i rrjetit të transportit dhe i strukturave urbane me harmoni.

Hulumtimet e kësaj pjese paraqesin planet e dy qyteteve për përfshirjen e transportit publik në strukturën urbane. Rasti i Ferizajit përqendrohet në stacionin hekurudhor me vendndodhje strategjike në aksin rrugor Prishtinë-Shkup, ndërkohë që Peja planifikon të fillojë me zbatimin e një rrjeti të planifikuar me kujdes të autobusëve të qytetit. Hekurudhat e Kosovës do të prezantojnë eksperiencat e para të linjës së rihapur hekurudhore Prishtinë-Peja.

Treni ekspres për Shkup, ndalimi në Ferizaj

Aktivitetet e ardhshme:

Sesioni akademik “Struktura urbane dhe transporti publik në qytetet moderne orientale dhe perëndimore” (E Premte, 23 Nëntor 2007), me Pierre LACONTE, Kryetar i ISOCARP-it, Sekretar Nderi i Përgjithshëm i UITP.

Konferenca e dytë mbi Transportin dhe Planifikimin Hapësinor në Kosovë
“Infrastrukturat themelore dhe mjedisi (Janar 2008)”

Kosova gjendet në qendër të Ballkanit Perëndimor. Zhvillimi ekonomik dhe social në Kosovë varet nga kapacitetet e saj për të transmetuar këtë situatë të favorshme në një rrjet dinamik të qyteteve të cilat janë të lidhura në mënyrë efektive me të gjitha vendet fqinje dhe tregun e largët, domethënë përmes koridoreve transpeuropiane. Këto lidhje duhet të paraqesin përdorimin më të mirë të resurseve të limituara: buxhetet, hapësirën dhe mjedisin e mirë kualitativ. Kjo konferencë do të ofrojë mundësi për të vlerësuar nevojat e tashme dhe të ardhme për shtyllën e infrastrukturës në Kosovë dhe të diskutojë mundësitë për zhvillim më adekuat.

Konferenca e Tretë mbi Transportin dhe Planifikimin Hapësinor në Kosovë
“Siguria në trafik dhe transporti jomotorik (Mars 2008)”


Aksidentet në rrugë paraesin brengë e cila po rritet në Kosovë. Fatkeqësitë janë duke u rritur në një mesatare prej rreth 7% në vit si dhe fatkeqësitë vjetore të këmbësorëve janë rritur rreth 103% në periudhën 2002-2006. Pavarësisht këtyre fakteve dramatike, transporti jo motorik është një transport mjaft shumë i preferueshëm i sistemit të transportit që e kursen energjinë, redukton emisionet dhe përmirëson shëndetin publik. Konferenca do të ngrit çështjen e përmirësimit të sigurisë në rrugë njëkohësisht duke promovuar politikat të cilat fuqizojnë format e transportit jo motorik.



Kontakti

MTPT:	Lulzim Rama, Zyrtar i Integritimit Evropian	Lulzim.Rama@ks-gov.net
MMPH:	Luan Nushi, Drejtor i Institutit për Planifikim Hapësinor	Luan.Nushi@ks-gov.net
AKK:	Sazan Ibrahim, Drejtor ekzekutiv	sazanibrahimi@komunat.net
UN-HABITAT:	Joachim Bergerhoff, Mobility Planning Expert	Joachim.Bergerhoff@unhabitat-kosovo.org

Konferencat mbi Transportin dhe Planifikimin Hapësinor në Kosovë janë të bashkë-organizuar nga Ministria e Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor, Asociacioni I Komunave të Kosovës dhe UN-HABITAT-it në Kosovë me mbështetjen e programit për Ngritjen e kapaciteteve për Integrim European (UNDP/EU).

Programi për Mbështetjen e Komunave në Planifikim Hapësinor në Kosovë i UN-HABITAT-it financohet nga  Sida
Vizitoni faqen tonë: www.unhabitat-kosovo.org